



KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

Tiranë më, 5.2.2019

Dokument parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 64/2012, DATË 31.5.2012 “PËR PESHKIMIN”, TË NDRYSHUAR”

- ***Hyrje***

Komisioni për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 64, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar”, në mbledhjet e datave 30 janar dhe 4 dhe 5 shkurt 2019.

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin caktoi deputeten Eglantina Gjermeni relatore për shqyrtimin e këtij projektligji.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve, ishin përfaqësues të ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 64, datë 31.5.2012, “Për peshkimin”, i ndryshuar”, është një nismë e Këshillit të Ministrave, e cila i paraqitet për shqyrtim Kuvendit, mbështetur në nenet 78, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës.

Miratimi i këtij projektligji kërkon një shumicë të thjeshtë votash, sipas nenit 55, pika 1 e Rregullores së Kuvendit.

- ***Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit***

Projektligji synon përcaktimin e rregullave për organizimin e peshkimit bregdetar artizanal, për një qasje më të afërt me fusha të rëndësishme të politikës së përbashkët të peshkimit të Bashkimit Evropian, dokumentit programatik të Unionit për mbështetjen dhe zhvillimin e sektorit të peshkimit, si dhe përcaktimin e parimeve mbi të cilat mbështetet dhe kushteve që duhet të plotësojnë organizatat e peshkimit për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së peshkimit të transferuar për menaxhim prej tyre.

Mënyra e organizimit të organizatave prodhuese, sipas ligjit 64/2012 "Për peshkimin", i ndryshuar", bazohet në rregulloren (KE) nr. 104/2000, e cila është shfuqizuar nga rregullorja e Këshillit nr. 1379/2013/KE, datë 11 dhjetor 2013, në lidhje me organizimin e përbashkët të tregjeve të prodhimeve të peshkimit dhe akuakulturës. Për këtë arsye, ndryshimet e propozuara bazohen në rregulloren nr. 1379/2013/KE, datë 11 dhjetor 2013.

Ndryshimet e propozuara synojnë:

- disiplinimin e aktivitetit të organizatave të peshkimit, me qëllim shmangien e peshkimit PPP (të paligjshëm, të pa raportuar dhe të parregulluar), raportimin e saktë të zënieve të peshkut, ruajtjen më të mirë të resurseve, përmirësimin e kushteve higjieno – sanitare të tregtimit dhe transportit të peshkut të zënë, rritjen e gjurmueshmërisë së produkteve të peshkimit, sigurimin e një qasjeje dhe informacion më të qartë e të plotë të konsumatorit për këto produkte.
- përcaktimin e parimeve mbi të cilat mbështetet dhe të kushteve që duhet të plotësojë organizata e peshkimit për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së peshkimit të transferuar;
- përcaktimin e formave, mënyrave dhe kriterëve për menaxhimin e infrastrukturës portuale;
- përcaktimin e përgjegjësive që do të ketë institucioni përgjegjës për shërbimet e peshkimit dhe të akuakulturës, si administratore e infrastrukturës portuale dhe e qendrave të ripopullimit të kategorive ujore, në pronësi dhe varësi të MBZHR-së.
- unifikimin e disa termave, me qëllim saktësimin e tyre.

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi***

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe me legjislacionin përkatës që rregullon këtë fushë në vendet anëtare të BE-së.

Në aspektin procedural projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në aspektin formal projektligji përbëhet nga 14 nene.

- ***Vlerësimi i përputhshmërisë së projektligjit me Acquis të BE-së***

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 64/2012, datë 31.05.2012 “Për Peshkimin”, të ndryshuar” është i parashikuar në Kapitullin 13: Peshkimi”, të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian.

Acquis e BE-së që përafrohet nga Projektligji i propozuar:

- **Legjislacioni parësor i BE-së:**

- Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE): *Titulli III “Bujqësia dhe peshkimi” neni 38 (ish-neni 32 TKE), neni 39 (ish-neni 33 TKE), neni 42 (ish-neni 36 TKE), neni 43 (ish-neni 37 TKE).*
- Marrëveshja e Stabilizimit Asociimit BE - Shqipëri (MSA): Kapitulli II “Bujqësia dhe peshkimi”, **neni 24 “Përkufizim”, neni 26 (shfuqizimi i kufizimeve sasiore dhe masave me efekt të njëjtë me të importet e produkteve bujqësore, përfshirë ato të peshkimit në tregtinë mes Shqipërisë dhe BE-së), neni 28 “Produktet e peshkimit”, Titulli VIII “Politikat e bashkëpunimit”, neni 96 “Peshkimi” dhe Shtojca III e MSA-së “Tarifat koncesionare të BE-së për peshkun dhe nënproduktet e peshkut shqiptar”.**

- **Legjislacioni dytësor i BE-së:**

- Rregullorja (BE) Nr. 1379/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 11 Dhjetor 2013 “Mbi organizimin e përbashkët të tregjeve për produktet e peshkimit dhe akuakulturës, që ndryshon Rregulloret e Këshillit (KE) Nr. 1184/2006 dhe (KE) Nr. 1224/2009 dhe shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 104/2000”, e ndryshuar”.
- Rregullorja (BE) Nr. 508/2014 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 15 Maj 2014 “Mbi Fondin Evropian Detar dhe të Peshkimit dhe që shfuqizon Rregulloret e Këshillit (KE) Nr. 2328/2003, (KE) Nr. 861/2006, (KE) Nr. 1198/2006 dhe (KE) Nr. 791/2007 dhe Rregulloren (BE) Nr. 1255/2011 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit”.

Niveli i Përafrimit: I pjesshëm

Shkalla e përafrimit të projektligjit të paraqitur me *acquis* të BE-së është e pjesshme. Pra, projektligji në fjalë është në përputhje (nuk bie në kundërshtim) me dispozitat e burimeve parësore dhe dytësore të Acquis të BE-së të lartpërmendura, por nuk është në përputhje me të gjitha parimet që rrjedhin prej këtyre dispozitave.

- **Konsultimi publik**

Referuar relacionit që shoqëron projektligjin, rezulton se në zbatim të detyrimeve të ligjit nr. 146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ky projektligj i është nënshtruar procesit të njoftimit dhe konsultimit publik nëpërmjet publikimit në regjistrin elektronik (RENJK), por përfaqësuesit e ministrisë sqaruan se nuk ka pasur komente apo sugjerime nga grupe interesi. Megjithatë, procesi i konsultimit të projektligjit është zhvilluar edhe në kuadër të Komisionit Konsultativ të Peshkimit, i cili drejtohet nga ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ka në përbërje të tij përfaqësues të grupeve të interesit, organizatave të prodhimit, të menaxhimit, ekspertë të fushës, etj.

Në respektim të parimit të transparencës dhe të gjithëpërfshirjes, mbi të cilat zhvillohet veprimtaria parlamentare, si dhe bazuar në përcaktimet e nenit 36 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni zhvilloi një séance dëgjimore me përfaqësues të organizatave të prodhuesve dhe të menaxhuesve të peshkimit.

Në fjalën e tyre përfaqësuesit e organizatave të menaxhimit të peshkimit vlerësuan ndryshimet e propozuara nëpërmjet projektligjit dhe u shprehën se nuk kanë vërejtje apo sugjerime.

Edhe përfaqësuesit e organizatave të prodhimit vlerësuan ndryshimet që propozon projektligji, duke i konsideruar të nevojshme dhe theksuan se tashmë i rëndësishëm është zbatimi i përcaktimeve ligjore.

Gjithashtu, në Komision ka dërguar komentet e saj Znj. Valbona Kolaneci, Drejtuese e Departamentit të akuakulturës dhe peshkimit, Fakulteti i Bujqësisë dhe Mjedisit, Universiteti Bujqësor i Tiranës.

Në komentet e saj Znj. Kolaneci thekson se ndryshimet në projektligj diktohen nga nevoja e përafrimit të Legjislacionit shqiptar të peshkimit me atë evropian e pikërisht lidhur me organizmin dhe rregullimin e funksionimit të organizatave të peshkimit dhe nevojën e bashkëpjesëmarrjes në hartimin dhe zbatimin e Planeve të Menaxhimit të Peshkimit.

Përmirësimet në Ligjin e Peshkimit synojnë të zgjerojnë fushat e veprimtarisë të organizatave të peshkimit duke përfshirë edhe kontributin e tyre në krijimin dhe menaxhimin e qendrave të grumbullimit dhe tregtimit, si edhe në garantimin e cilësisë dhe sigurisë së produkteve peshkore.

Projekt-ndryshimet adresojnë më qartë kushtet për menaxhimin e infrastrukturës së peshkimit në rastet e transferimit të menaxhimit të saj tek organizatat e peshkimit.

Gjithashtu, Znj Kolaneci ka bërë komente për nene konkrete të projektligjit, kryesisht lidhur me; risaktësime/riformulime të përkufizimeve; riformulime lidhur me objektivat e organizatave të prodhuesve dhe infrastrukturën e peshkimit dhe përkufizimin e konceptit të së drejtës së peshkimit.

- **Diskutimi në komision**

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në Komision, relatorja kërkoi shpjegime nga propozuesit lidhur me nevojën e kryerjes së këtyre ndryshimeve në ligj, me procesin e konsultimit publik të ndjekur nga

propozuesi dhe propozoi zhvillimin e një séance dëgjimore, me qëllim shqyrtimin e projektligjit bazuar në parimin e gjithëpërfshirjes.

Lidhur me nevojën e kryerjes së ndryshimeve në ligj, propozuesit e ministrisë sqaruan se ligji nr. 64, datë 31.05.2012, “Për peshkimin”, i ndryshuar”, është hartuar në mbështetje të pesë rregulloreve të KE-së, njëra nga të cilat, ajo nr.104/2000, është shfuqizuar nga rregullorja e Këshillit nr.1379/2013/KE, datë 11 dhjetor 2013. Kjo rregullore përcakton detyrime në lidhje me organizimin e përbashkët të tregjeve të prodhimeve të peshkimit dhe akuakulturës. Ndryshimet e propozuar janë hartuar me qëllim transpozimin e kësaj rregullore dhe detyrimeve që ajo vendos.

Përfaqësuesit e ministrisë sqaruan se në zbatim të ligjit nr.146/2014, “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ky projektligj i është nënshtruar procesit të njoftimit dhe konsultimit publik nëpërmjet publikimit në regjistrin elektronik (RENJK), por nuk ka pasur komente apo sugjerime nga grupe interesi. Por, procesi i konsultimit të projektligjit është zhvilluar edhe në kuadër të Komisionit Konsultativ të Peshkimit, i cili drejtohet nga ministri I Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ka në përbërje të tij përfaqësues të grupeve të interesit, organizatave të prodhimit, të menaxhimit, ekspertë të fushës, etj.

Gjatë diskutimeve, anëtarët e Komisionit kërkuar sqarime lidhur me raportin e legjislacionit vendas me atë të BE-së në fushën e peshkimit, raportin ndërmjet kompetencave që ligji u jep organizatave prodhuese dhe atyre menaxhuese, konceptin e lejes së peshkimit dhe të drejtës së peshkimit, me qëllim që të mos krijohen mbivendosje, si dhe kërkuar të dhëna statistikore mbi numrin e shoqatave dhe individëve që ushtrojnë peshkim artisanal, numrin e lejeve të peshkimit, etj.

Përfaqësuesit e ministrisë sqaruan se lidhur me pajisjen e subjekteve me leje për peshkimin argëtues/çlodhës, është ndjekur modeli kroat dhe ai Italian, sipas të cilit do të krijohet një website ku subjektet që ushtrojnë këtë formë peshkimi duhet të aplikojnë online për t’u pajisur me leje peshkimi dhe automatikisht do t’u gjenerohet leja nga sistemi. Subjektet që ushtrojnë peshkim me mjete lundruese pajisen me leje peshkimi nga QKB-ja, ndërsa subjektet që ushtrojnë forma të tjera peshkimi, pa mjete lundruese, do t’i nënshtrohen konkurrit publik për të përfituar të drejtën e peshkimit.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit nen për nen deputetët diskutuan për problematika të neneve të veçanta, lidhur me : çështjen e përkufizimit “peshkim tregtar artizanal”, duke e krahasuar me përkufizimin e dhënë nga rregullorja; me konceptet e të drejtës së peshkimit dhe lejes së peshkimit;detyrat e institucionit përgjegjës për peshkimin dhe nevojën për shtimin e përkufizimit për “infrastrukturën e peshkimit” dhe infrastrukturën që lidhet me peshkimin”.

Lidhur me çështjet e ngritura për diskutim, përfaqësuesit e ministrisë sqaruan se:

Përkufizimi “peshkim tregtar artizanal” është një përkufizim në ligjin ekzistues dhe ndryshimi i tij në projektligj do të përbënte problem pasi mbi të është ngritur e gjithë infrastruktura e peshkimit. Projektligji shton vetën përkufizimin ‘peshkim bregdetar artizanal’, për ta përputhur me rregulloren nr.1379/2013/KE, datë 11 dhjetor 2013.

Koncepti i të drejtës së peshkimit është një koncept i gjerë që përfshin të drejtën e përdorimit të një resursi peshkimi, ndërsa leja e peshkimit është një nga mënyrat nëpërmjet të cilave ushtrohet e drejta e peshkimit.

Institucioni përgjegjës i parashikuar në nenin 12 të projektligjit është një institucion ekzistues, detyrat e të cilit janë të përcaktuara në nenin 65 të ligjit dhe nuk ndryshojnë. Ndryshimi që propozon projektligji konsiston vetëm në heqjen e detyrës së hartimit të politikave, e cila kryhet nga ministria.

- ***Ndryshime të projektaktit***

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni, me shumicë votash, e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe u shpreh dakord për kalimin e tij për votim në seancë plenare. Deputetët e opozitës nuk ishin të pranishëm.

Gjatë shqyrtimit nen për nen, Komisioni, pasi u njoh edhe me raportin e Komisionit Parlamentar për Integrimin European, u shpreh dakord me propozimet e paraqitura prej tij, duke i bërë pjesë të vërejtjeve të tij si më poshtë:

1. Shënimi në fund të faqes që lidhet me titullin e projektligjit të riformulohet si vijon:

“Ky ligj është përafëruar pjesërisht me:

- Rregulloren (BE) Nr. 1379/2013 të Parlamentit European dhe të Këshillit, datë 11 Dhjetor 2013 “Mbi organizimin e përbashkët të tregjeve për produktet e peshkimit dhe akuakulturës, që ndryshon Rregulloret e Këshillit (KE) Nr. 1184/2006 dhe (KE) Nr. 1224/2009 dhe shfuqizon Rregulloren e Këshillit (KE) Nr. 104/2000”, e ndryshuar. Numri CELEX 32013R1379, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, seria L, nr.354, datë 28.12.2013, fq.1-21.
- Rregulloren (BE) Nr. 508/2014 të Parlamentit European dhe të Këshillit, datë 15 Maj 2014 “Mbi Fondin European Detar dhe të Peshkimit dhe që shfuqizon Rregulloret e Këshillit (KE) Nr.2328/2003, (KE) Nr.861/2006, (KE) Nr.1198/2006 dhe (KE) Nr.791/2007 dhe Rregulloren (BE) Nr.1255/2011 të Parlamentit European dhe të Këshillit”. Numri CELEX 32014R0508, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr.149, datë 20.05.2014, fq.1-66.”

2. **Neni 2** të riformulohet si vijon:

“Neni 2

Në nenin 4 bëhen këto ndryshime:

1. *Pas pikës 22, të shtohen pikat 22/1 dhe 22/2 me përmbajtje si vijon:*

“22/1. “Infrastruktura e peshkimit”, është tërësia e trojeve, kalatave, godinave dhe çdo objekti tjetër i paluajtshëm në territorin e portit të peshkimit apo qendrës së peshkimit, përfshirë muret rrethuese të tij dhe akuatoriumin, instalimet e sinjalizimit, të ndriçimit dhe të komunikimit brenda territorit të portit dhe në kanalin hyrës.

22/2. “Infrastruktura që lidhet me peshkimin”, është ajo pjese e infrastrukturës së peshkimit e cila përbëhet nga merkatot, shkallet e riparimit të anijeve të peshkimit dhe depozitat e karburantit të cilat janë ndihmuese në zhvillimin e aktivitetit të peshkimit.”.

2. Pika 63 ndryshohet si vijon:

“63. “Peshkim tregtar artizanal ose peshkim bregdetar artizanal” është peshkimi tregtar që zhvillohet nga anije më të vogla se 12 metra dhe që nuk përdorin vegla peshkimi fundor, me ose pa timon, vegla peshkimi me tërheqje të peshkimit pelagjik me timon ose çift pelagjik, rrjeta binjake me timon dhe draga hidraulike.”.

3. Pas pikës 64 shtohet pika 64/1, me përmbajtje si vijon:

“64/1. “Peshkim pa përdorimin e mjeteve lundruese”, janë të gjitha format e peshkimit për zënien apo grumbullimin e peshqve dhe të organizmave detare/ujore, të cilat kryen pa përdorimin e mjeteve lundruese.”.

4. Pas pikës 83 shtohet pika 83/1, me përmbajtje si vijon:

“83/1. “Sistem i monitorimit të anijes”, janë pajisjet hardware & softëare dhe pajisjet MTU (Mobile Transceiver Unit) të instaluar në bordin e anijeve të peshkimit, të cilat realizojnë identifikimin e një anijeje, pozicionin e saj gjeografik, datën, orën, kursin, shpejtësinë dhe që mundësojnë transmetimin e të dhënave ndërmjet saj, Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD) dhe ministrisë, sipas përcaktimeve të nenit 67, të këtij ligji.”.

3. **Neni 4** të riformulohet si vijon:

“Neni 4

Në nenin 30 të bëhen ndryshimet si vijon:

1. Pika 1 të riformulohet:

“1. Leja e peshkimit tregtar përfshihet në kategorinë III.5. A.1. të shtojcës së ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”. Leja e peshkimit tregtar lëshohet, menaxhohet dhe hiqet në përputhje të plotë me procedurat e

përcaktuara në këtë ligj dhe në ligjin nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

2. Pas pikës 6 shtohet pika 7 me përmbajtje si vijon:

“7. E drejta e peshkimit për format e tjera të peshkimit në det, pa përdorimin e mjeteve lundruese, me përjashtim të rasteve kur ndalohet nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e mjedisit, fitohet nëpërmjet konkurrimit publik dhe përfshihet në kategorinë III.5 A.2 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, Procedurat e konkurrimit publik përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.””.

4. **Neni 8** të riformulohet si vijon:

“Neni 8

Neni 61 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 61

Organizatat e prodhuesve

- 1. Organizatat prodhuese të peshkimit, të njohura sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj, krijohen me nismën e prodhuesve të produkteve të peshkimit.*
- 2. Në momentin e njohjes së organizatës prodhuese, nga autoriteti i përcaktuar në ligj, duhet të mbahet parasysh gjendja specifike e prodhuesve të vegjël.”.*

5. **Në nenin 9**, të projektligjit, i cili shton nenet 61/1 dhe 62/2 në ligj, të bëhen këto ndryshime:

1. **Në nenin 61/1:**

a. **Pika 1, shkronja “b” të riformulohet si vijon:**

”b) Parandalojnë dhe zvogëlojnë sa më shumë që të jetë e mundur zëniet jo objekt peshkimi të popullatave tregtare dhe kur është e nevojshme, të bëjnë përdorimin më të mirë, pa krijuar treg për zëniet që janë nën dimensionet minimale, të përcaktuara për mbrojtje, sipas akteve nënligjore;”;

b. **Pika 3 të riformulohet si vijon:**

*“3. Organizatat prodhuese mund të ndjekin objektiva **të tjerë** plotësues”.*

2. **Në nenin 61/2,** në pikën 1, shkronja “a”, fjala “resurset” të zëvendësohet me fjalën “burimet”.

6. **Në nenin 11** të projektligjit, që ndryshon nenin 65 të ligjit, të bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 2, shkronja “c” të riformulohet si vijon:

“c) Menaxhim i infrastrukturave të lidhura me peshkimin nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe subjektet private”

2. Pika 3 të riformulohet:

“3. Kushtet dhe procedurat e transferimit të menaxhimit të infrastrukturës së peshkimit te organizatat e peshkimit , njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe subjektet private miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

7. **Në nenin 12**, shprehja “në pikën 2, të nenit 65” të zëvendësohet me shprehjen “në pikën 3, të nenit 65”.

8. **Në nenin 13, pas pikës 3 të shtohet pika 4, me përmbajtje si vijon:**

“4. Aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji miratohen brenda një afati prej 12 muajsh nga data e hyrjes në fuqi të tij.”

RELATORE

KRYETAR

Eglantina Gjermeni

Niko PELESHI